

VENDIM
Nr.1348, datë 10.10.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.160, DATË 13.2.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE «PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE PËR VITIN 2008
NË MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QENDRORE», TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.160, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Ministrisë së Brendshme, në numrin e punonjësve të miratuar për vitin 2008, t'i shtohen edhe 60 punonjës, për krijimin e komisioneve vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë. Numri i përgjithshëm i punonjësve të kësaj ministrie, për periudhën tetor-dhjetor 2008, bëhet 13 125.

2. Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në numrin e punonjësve, të miratuar për vitin 2008, t'i shtohen edhe 5 punonjës, për krijimin e sekretariatit teknik të komisionit qeveritar të tokës. Numri i përgjithshëm i punonjësve të kësaj ministrie, për periudhën tetor-dhjetor 2008, bëhet 2 114.

3. Numri i përgjithshëm i punonjësve buxhetorë, për vitin 2008, për periudhën tetor-dhjetor 2008, bëhet 104 396 veta, i paraqitur në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha